



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

**MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË
PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E
VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PËR VITIN 2023” .**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019 “ Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese” , VKM nr. 458, datë 3.7.2019,shkresës së M.F.E me nr.23964, datë 28.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1.Të miratoj , deklaratën për bashkëfinancimin e bashkisë Berat në projektin “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“, për vitin 2023 në masën 30 % të kostos totale të projektit.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE ,TRANSPORTIT DHE SHËRBIM

RELACION

MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PËR VITIN 2023 ” .

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese prej tre vitesh Bashkia Berat është bërë bashkëfinacuese në masën në projektit “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“.

Për vitin 2020 nga zbatimi i këtij projekti përfituan përmirësim të banesave 14 familje me kosto totale të projektit në vlerën 11,930,760 leke .

Ndërsa për vitin 2021, përfituan përmirësim të banesave 36 familje me kosto totale të projektit në vlerën 33,347,697 leke .

Ndërsa për vitin 2022, përfituan përmirësim të banesave 47 familje me kosto totale të projektit në vlerën 45,884,667 leke .

Bashkia Berat edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Financave “Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2023 ”.

Nisur nga numri i madh i familjeve ne nevojë të identifikuar nga ana jonë, banesat e të cilave janë të amortizuara dhe jashte kushteve teknike, ne edhe këtë vit po përgatisim dosjen për të aplikuar për këtë projekt.

Një nga kushtet që duhet të plotësojë Bashkia për t’u kualifikuar është përqindja e bashkëfinancimit për projektin, që për këtë vit për bashkinë tonë ka ndryshuar.

Bazuar në tabelën nr.2 “ Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurave vjetore për fyre të cilat për vitin 2021“ të termave të referencës të projektit për Bashkinë Berat , janë 4,004 mijë lekë dhe përqindja maksimale e financimit nga buxheti i shtetit është deri në 70% të koston totale të projektit dhe pjesa tjetër 30% do të mbulohet nga fondet e bashkisë.

Nga sa më sipër, ne ju propozojmë të miratoni financimin në masën 30 % të koston së projektit “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“.

Drejtor i M.C.P.T.SH

Erlin KUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KRYETARI

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin CECA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues “Mbi miratimin e deklaratës për bashkëfinancimin e bashkisë në projektin “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara per vitin 2023” .

K R Y E T A R I

Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuç, Drejtor i Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Transportit

Rovena Shehu, Drejtorja e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave

Konceptoi: Meleqe Spahiu,Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

PROJEKTVENDIM

PËR MIRATIMIN E QIRASË MESATARE MUJORE TË BANESAVE NË TREGUN E LIRË

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni neni 8, 9, neni 24, neni 64 gërma c ; ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social ” neni 73/v dhe VKM Nr.459 ,datë 03.07.2019 “Për administrimin e kërkesave të Njesisë së Qeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit , për subvencionim e procedurave dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

Propozon :

1. Miratimin e nivelit të qirase mesatare mujore gjatë vitit 2022 të banesave në tregun e lirë sipas strukturës së apartamentit , si më poshtë:

1.Për Lagjien Nr.1dhe Nr.3

- Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 10000 - 14000 lekë.
- Për apartamentinme strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 15000 – 18000 lekë.

2.Për Lagjien Nr.2

- Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 12000-16000 lekë.
- Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 16000-20000 lekë.

2.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Sherbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE ,TRANSPORTIT DHE SHËRBIM

RELACION

PËR MIRATIMIN E QIRASË MESATARE MUJORE TË BANESAVE NË TREGUN E LIRË

Të nderuar Këshilltare!

Bashkia Berat në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për strehimin ,për zbatimin e politikave të strehimit për familjet e pastreha, kanë planifikuar fonde për financimin e bonusit të strehimit për vitin 2023, për qytetarët në nevojë për t'u strehuar , nisur dhe nga fakti që ka shumë familje të pastreha që kërkojnë dhe plotësojnë kriteret për përfitimin e bonusit të strehimit ,pasi ne nuk kemi banesa sociale të lira për tu ndarë .

Por kërkesat e shumta për bonus strehimi shoqërohen me vështirësi, për gjetjen e banesave në tregun e lire edhe pse ka shumë banesa bosh ,pronarët e tyre hezitojnë ti japin me qira , pasi nuk kanë besim te qiramarrësit se ata do të jenë korrekt në pagesat e konsumimit të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm dhe frika nga tatimi sidomos fakti që ata do të taten në vlerën 15% të çmimit të kontratës së qirasë/ mujore edhe pse nga ana jone jane sqaruar se përjashtohen nga ky tatim me ligj.

Mbështetur në VKM Nr.459 ,datë 03.07.2019 “Për administrimin e kërkesave të Njësisë së Qeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit , për subvencionim e procedurave dhe përparësive për dhënie e bonusit të strehimit” , ne duhet të paraqesim pranë M.F.E , kërkesat për bonus strehimi, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përfituese të miratuar me Vendimin të Këshillit Bashkiak.

Për përfundimin e procedurës është e nevojshme miratimi i qirasë mesatare në tregun e lire, sipas strukturës së apartamentit, pasi nuk ka akte ligjore apo nënligjore që të përcaktojnë nivelin e qirasë sipas Bashkive .

Për sa më sipër ju propozojme miratimin e çmimit mesatar të qirasë në tregun e lire ,të marra gjatë vitit 2022 ,sipas strukturës së apartamentit dhe vendodhjes së tij si më poshtë:

1.Për Lagjjen Nr.1dhe Nr.3

-Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 10000 - 14000 lekë.
-Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 15000 – 18000 lekë.

2.Për Lagjjen Nr.2

-Për apartamentin me strukturë 1+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 12000—16000 lekë.
- Për apartamentin me strukturë 2+1 qiraja mesatare mujore është në vlerën 16000—20000 lekë.

DREJTORI MCPTSH

Erlin KUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KRYETARI

Nr. _____ prot.

Berat , më _____.____. 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin CECA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin “ Mbi miratimin e qirasë mesatare mujore të banesave në tregun e lire “.

KRYETARI

Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuç, Drejtor i Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Transportit

Konceptoi: Meleqe Spahiu,Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2